

## Informacione për COVID-19 (16.10.2020)



### 1. ÇFARË MUND TË BËJ UNË, NËSE KAM SIMPTOMA TË COVID19?

Nëse keni simptoma, ju lutemi drejtojeni përmes telefonit mjekut apo mjekes suaj të familjes, i cili ose e cila do të vlerësojë, nëse dyshohet për sëmundjen Covid 19. Përndryshe, telefononi shërbimin mjekësor të gadishmërisë nën numrin 116 117.

Një listë të të gjithë mjekëve, që kryejnë testime të Coronës në rajonin tuaj mund t'i gjeni këtu:

**Kassenärztliche Vereinigung** Shoqata e Mjekëve të Sigurimeve Shëndetësore Ligjore/ Baden-Württemberg:

[https://www.kvbawue.de/buerger/notfallpraxen/corona-anlaufstellen/corona-karte/?tx\\_praxenmap\\_pi1\[action\]=csplist&tx\\_praxenmap\\_pi1\[controller\]=Praxis&cHash=8c8f8683d22b8d06983b0bdf0c165365#map](https://www.kvbawue.de/buerger/notfallpraxen/corona-anlaufstellen/corona-karte/?tx_praxenmap_pi1[action]=csplist&tx_praxenmap_pi1[controller]=Praxis&cHash=8c8f8683d22b8d06983b0bdf0c165365#map)

### 2. INFORMACIONE PËR UDHËTARËT HYRËS / VIZITAT NGA VENDET E TRETA

Shtetasit e vendeve të treta anëtarë familjarë të ashtuquajturës "familje bërtham" (dmth bashkëshortët, bashkëjetuesit të të njëjtit seks të regjistruar dhe fëmijët e mitur ose prindërit e fëmijëve të mitur) të gjermanëve, shtetasve të BE-së ose shtetasve të Islandës, Liechtenshtajnit, Norvegjisë, Zvicrës ose Mbretërisë së Bashkuar ose të shtetasve të vendeve të treta me një të drejtë ekzistuese të qëndrimit në Gjermani lejohen të hyjnë në Gjermani për udhëtime vizitash të përkohshme familjare. Kjo vlen pavarësisht nga ajo, nëse anëtarët e familjes anëtarë të vendit të tretë udhëtojnë së bashku me personin referues ose vetëm.

**Hyrja afatshkurtër në vend e shtetasve të vendeve të treta, që janë të afërm të shkallës 1 dhe 2 vetëm nëse ka arsye madhore familjare.**

Të afërmit e shkallës së 1 dhe 2 të vendeve të treta, për shembull fëmijët në moshë madhore, prindërit e fëmijëve në moshë madhore, vëllezërit e motrat dhe gjyshërit), të gjermanëve, shtetasve të BE-së ose shtetasve të Islandës, Liechtenshtajnit, Norvegjisë, Zvicrës ose Britanisë së Madhe dhe shtetasve të vendeve të treta me një të drejtë qëndrimi ekzistuese në Gjermani parimisht

**nuk** lejohen të hyjnë në vend vetëm për udhëtime vizitash të përkohshme familjare.

**Anëtarëve më të largët të familjes që janë shtetas të vendeve të treta, që nuk janë të afërm të shkallës së parë ose të dytë, parimisht nuk u lejohet të hyjnë në vend vetëm për arsye familjare.**

### 3. INFOMACIONE PËR PERSONAT E KTHYER NGA UDHËTIMI

EGZISTON NJË **OBLIGIM TESTIMI** PËR PERSONAT, QË HYJNË NGA ZONAT E RREZIKUARA. PËRSA KOHË NUK PARAQITET ASNJË REZULTAT NEGATIV I TESTIT, UDHËTARËT HYRËS NGA ZONAT E RREZIKUARA DUHET TË FUTEN NË KARANTINË 14 DITORE. Kushdo, që hyn në Gjermani nga një zonë e rrezikuar, duhet gjithashtu të plotësojë veç kësaj një të ashtuquajtur kartë zbritjeje tashmë para hyrjes në vend.

Nëse ktheheni në Mannheim nga një zonë e rrezikuar, **duhet** të shkoni menjëherë në karantinim në shtëpi dhe të lajmëroni qytetin e Mannheim-it!

Ju lutemi menjëherë të dërgoni një E- Mail në:

[31corona@mannheim.de](mailto:31corona@mannheim.de)

[ Në E-Mail duhet të shënohen **të gjithë** personat e familjes suaj / me familje e katandi që kanë hyrë në vend: me emrat, datën e lindjes, datën e hyrjes në vend, eventualisht numrin e fluturimit, nga cili vend/cilat shtete jeni kthyer dhe ku keni qëndruar 14 ditë para hyrjes në vend.

Qyteti i Mannheim-it ka nevojë për adresën e juaj të E- Mail-it, adresën e juaj të vendbanimit (ku do të kalohet karantina) dhe nëse është e mundur, një numër telefoni në mënyrë që të mund t'ju kontaktojnë shpejt.

### 4. KU DHE SI MUND TË TESTOHENI?

Urdhëresa i obligon udhëtarët hyrës nga zonat e rrezikuara, që të bëjnë një test për Coronën kur hyjnë në Gjermani. Në mënyrë alternative udhëtarët, që hyjnë në vend mund të paraqesin një rezultat negativ të testimit, i cili nuk duhet të jetë më i vjetër se 48 orë.

Zonat aktualisht të rrezikuara mund t'i gjeni këtu:

[https://www.rki.de/DE/Content/InfAZ/N/Neuartiges\\_Coronavirus/Risikogebiete.html](https://www.rki.de/DE/Content/InfAZ/N/Neuartiges_Coronavirus/Risikogebiete.html)

Testi duhet të jetë bërë në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian ose në një laborator tjetër të listuar nga Instituti Robert Koch nën adresën

[www.rki.de/covid-19-tests](http://www.rki.de/covid-19-tests). Vërtetimi i testit duhet të jetë i përpiluar në gjuhën gjermane ose në anglisht.

Formulimin e saktë të urdhëresës për obligimin e kryerjes së testimit të udhëtarëve, që hyjnë nga zonat e rrezikuara ju e gjeni nën

[https://www.bundesgesundheitsministerium.de/fileadmin/Dateien/3\\_Download/s/C/Coronavirus/Testpflicht\\_Risikogebiete\\_VO\\_BAnz\\_AT\\_070820.pdf](https://www.bundesgesundheitsministerium.de/fileadmin/Dateien/3_Download/s/C/Coronavirus/Testpflicht_Risikogebiete_VO_BAnz_AT_070820.pdf)

**AKTUALISHT UDHËTARËVE, QË HYJNË NGA ZONAT E RREZIKUARA  
U OFROHEN TESTIME FALAS:**

- Qendra testimi me teste falas në të gjitha aeroportet.
- Qendra testimi në disa stacione treni (për shembull Stuttgart)
- Qendra testimi në lokalet e ndryshme të pushimit në autostradat pas pikave të kalimeve kufitare.
- Ndëmjetësim i terminave tek mjekët përmes Shoqatës së Mjekëve të Sigurimeve Shëndetësore Ligjore/ Kassenärztliche Vereinigung:
- Tel: 116117 (pa prefiks) ose testimet në rajon:  
[https://www.kvbawue.de/buerger/notfallpraxen/corona-anlaufstellen/corona-karte/?tx\\_praxenmap\\_pi1\[action\]=csplist&tx\\_praxenmap\\_pi1\[controller\]=Praxis&cHash=8c8f8683d22b8d06983b0bdf0c165365#map](https://www.kvbawue.de/buerger/notfallpraxen/corona-anlaufstellen/corona-karte/?tx_praxenmap_pi1[action]=csplist&tx_praxenmap_pi1[controller]=Praxis&cHash=8c8f8683d22b8d06983b0bdf0c165365#map)
- Për udhëtarët (shtetas jo gjerman ose personat, që nuk banojnë në Gjermani), të cilët hyjnë në Gjermani, NJË testim falas nuk është i garantuar. (Shpenzimet e shkaktuara duhet të përballohen vetë nga ata)
- Qendra e testimit në Klinikën e Mannheim -it është vetëm për personat me simptoma.

Pavarësisht nga një test i kryer, patjetër ju duhet të lajmëroheni tek autoriteti lokal [31corona@mannheim.de](mailto:31corona@mannheim.de) , pas rihyrjes në vend nga një zonë e rrezikuar! Informacione të mëtejshme aktuale në gjuhë të ndryshme mund t'i gjeni gjithashtu në faqen kryesore të internetit (Homepage) të qytetit të Mannheim-it nën

<https://www.mannheim.de/de/informationen-zu-corona/informationen-in-verschiedenen-sprachen>

**Kujdesuni për veten dhe të tjerët dhe qëndroni të shëndetshëm!**